



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.06.2019, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Bashkim Fino, Spartak Braho, Aurora Mara, Elena Xhina, Ediola Braha, Xhemal Qefalia dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Damian Gjiknuri, Alket Hyseni, Adriatik Alimadhi, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Artan Syziu - Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve në Ministrinë e Drejtësisë

Tedi Dobi – ekspert vendas nga EURALIUS-i

Marjana Papa- këshilltare ligjore në OSBE

Kujtim Luli - prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Ardian Nezha –këshilltar nga Avokati i Popullit

Kleves Janku- specialist i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit

Rural

Ardit Tabaku- specialist i AKU-së

Saina Mezini - përfaqësues i shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”

Meri Koça- përfaqësues i shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e dytë të komisionit për ditën e sotme.

Kourumi është i bërë për të vazhduar me çështjen e rendit të ditës: “Shqyrtimi dhe miratimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Elena Xhina. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë, zoti Syziu, përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve, nga misioni EURALIUS zoti Tedi Dobi ekspert, nga OSBE-ja zonja Papa, nuk është paraqitur, nga Prokuroria e Përgjithshme, zoti Kujtim Luli, prokuror, nga Avokati i Popullit zoti Ardian Nezha, këshilltar, nga Ministria e Bujqësisë zoti Kleves Janku, përfaqësues i Drejtorisë Juridike, nga shoqata “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”, zonja Mezini dhe zonja Koça.

E kemi lënë te neni 288, me të cilin kemi filluar shqyrtimin e paketës së sigurisë ushqimore “Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin”.

Elena Xhina- Faleminderit!

Po përsëris disa aspekte të nenit 288, që u thanë në seancën e paradites.

Sa i përket këtij neni, nga grupi i punës është parë me vend që të ndryshohet që në titull dispozita. Ka disa riformulime duke përfshirë importimin, prodhimin, shitjen dhe ruajtjen e ushqimeve të rrezikshme për ruajtjen e shëndetit ose jetën e njerëzve.

Nga diskutimi që u bë ramë dakord që ta heqim fjalinë “kur është marrë më parë masa administrative” nga dispozita për ta përforcuar dhe më tej dhe për të arritur qëllimin për të cilin nismëtarët e shtuan këtë dispozitë: “Importimi, prodhimi, ruajtja shitja ose vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve ose futja në prodhimin e artikujve ushqimorë e kimikateve dhe e lëndëve shtesë që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve, në shkëlqje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm dënohet me burgim deri në 3 vjet. Nga kjo vepër penale, kur ka ardhur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit dënohet me burgim nga 3-10 vjet; kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave dënohet me burgim nga 10-25 vjet; kur kjo vepër penale kryhet nga pakujdesia dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit”.

Ulsi Manja - Unë shoh që pijet i keni futur në një kategori brenda ushqimeve. A është i saktë ky kategorizim?

Elena Xhina-Kjo është bërë në referim të ligjit të posaçëm, i cili të gjitha pijet i kategorizon si ushqime.

Ulsi Manja – Atëherë, unë mendoj se paragrafi i fundit, që nuk ka qenë në variantin e propozuesve, “kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia dënohet me gjobe ose burg deri në 1 vit”, nuk ka kuptim. Pra, nëse ne do t’i referohemi pasojës, siç edhe është formulimi, ky paragraf nuk qëndron. Kush është dakord me nenin 288 sipas propozimit që lexoi zonja Xhina? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 21.

Elena Xhina- Lidhur me nenin 21, nga ana e deputetëve nismëtarë është depozituar dispozitë, e cila parashtron prodhimin, importimin, prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve, pijeve, barnave dhe artikujve ushqimorë jashtë standardeve të tregtimit. Pra, është marrë një aspekt i sigurisë ushqimore, që është afati i përdorimit, por, duke miratuar nenin 288, ne i kemi përfshirë të gjitha aspektet ligjore që flasin për importimin, prodhimin, shitjen që janë në kundërshtim me ligjin. Brenda këtij rrethi të madh, që ne kemi përfshirë, hyjnë edhe afati i përdorimit ose skadencia. Kështu që nga grupi i punës, por edhe nga grupet e interesit u pa me vend që kjo dispozitë është e tepërt. Prandaj, ne kemi propozuar që të mos jetë në draft pasi ajo mbulohet nga neni 288 të cilin sapo e miratua.

Kujtim Luli- Është diskutuar, është një ndër rastet që mund të jetë në shkelje të ligjit mbajtja dhe importimi pas afatit të përdorimit, ashtu siç është edhe dispozita më poshtë që lidhet me etiketimin. Të gjitha këto janë aspekte të shkeljes ligjore të ligjit për ushqim dhe të gjitha përfshihen te neni 288 që sapo u miratua.

Ulsi Manja- Kush është dakord që neni 21 të hiqet? Kundër? Abstenime?

Miratohet. Hiqet neni 288/c.

Vazhdojmë me 288/d “Mashtrimi me produktet ushqimore”.

Elena Xhina-Lidhur me këtë nen, ne nuk kemi bërë ndryshime, e kemi lënë sipas propozimit, por do të hiqen fjalët “pije” dhe “barna”. Për pijet e sqaruam që futen tek ushqimet, ndërsa barnat parashikohen në një dispozitë tjetër të Kodit Penal.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Xhina, për këtë sqarim, por unë kam një sqarim tjetër lidhur me barnat.

Dispozita që është në fuqi lidhur me mashtrimet me barnat, a është në të njëjtin standard me rregullimet që ne po parashikojmë për produktet ushqimore, apo është një dispozitë, e cila ka nevojë të rishikohet?

Faleminderit!

Elena Xhina- Dispozita që është në fuqi nuk i mbulon të gjitha aspektet, por ne nuk mund të miratojmë këtu një dispozitë që mbivendoset në një dispozitë tjetër. Duke qenë para faktit që Kodi Penal është në ndryshim e sipër, mundemi që të gjitha këto mendime t'i depozitojmë pranë Ministrisë së Drejtësisë për të ndryshuar dispozitën që është për barnat.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Një nga problemet e sigurisë dhe që ka të bëjë me shëndetin e qytetarëve, nuk është vetëm importimi, prodhimi e tregtimi i ushqimeve pijeve dhe artikujve të tjerë ushqimorë jashtë afatit të përdorimit, por është mashtrimi me barnat, cilësinë skadencën e të tjera. Besoj se të gjitha emisionet, por edhe njoftimet e fundit që ka dhënë BE-ja për produktet dhe barnat që prodhohen vetëm brenda BE-së, në mashtrim me ligjin dhe që tregtohen në vendet e BE-së dhe eksportohen, kanë probleme serioze, kjo sipas raportit për vendet e BE-së që është bërë publik për vendet e BE-së.

Prandaj, unë do të sugjeroja që problemi me mashtrimet me barnat qoftë importimi, por edhe dhe tregtimi i tyre, të skaduar ose jashtë standardeve duhet të gjejë rregullim tani. Nuk mund të presim sa të hyjë në fuqi kodi i ri, i cili, në vlerësimin tim, pa dy, tre vjet nuk mund të bëhet.

Ulsi Manja-Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Do të lexoj nenin 284/d të Kodit aktual Penal: “Prodhimi, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja ose ofrimi për shitje furnizimi, shpërndarje, eksportimi, importimi i barnave, i substancave aktive ose lëndëve ndihmëse për prodhimin e tyre, si edhe produkteve dhe pajisjeve mjekësore, aksesoreve, pjesëve përbërëse ose materialeve të tyre të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin, dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet”. Pra, kjo dispozitë parashikon më tepër figura se sa mashtrimi që ne kemi konkretisht, prandaj unë mendoj se aktualisht kjo dispozitë e mbron konsumatorin dhe individin.

Mund të ketë nevojë për rregullim ose ashpërsim, por për momentin është e mbuluar.

Vasilika Hysi -Zonja Xhina, sipas mendimit tim, në atë dispozitë që lexuat, mbase e lexuat shpejt, por unë nuk arrita ta kap propozimin që bën grupi i deputetëve propozues, ku thuhet që importohen, ruhen, ofrohen për shitje barna, të cilat të dhënat e shënuara aty nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë, cilësisë së produktit ose produkteve pa të dhënat e mësipërme.

Nëse keni parasysh edhe atë çka autoriteti ka denoncuar para disa ditësh për cilësinë e barnave në rastin e trajtimit të sëmundjeve të veshkave, janë mashtrime, të paktën nga gjetjet e Autoritetit të Konkurrencës. Këto nuk dalin te ky nen që sapo lexuat.

Ndoshta përfaqësuesit e prokurorisë mund të japin një mendim...

Ulsi Manja - Jemi te neni 288?

Vasilika Hysi – Ne po krahasojmë nenet 288/d, që keni propozuar ju si grup propozues, ku përfshihen produktet ushqimore, pijet dhe barnat, me nenin ekzistues 284, që trajton problemet me barnat.

Janë disa forma ose elemente të anës objektive të kësaj vepre, por tregtuesit e tjerë, të ofrojnë për shitje barna, të cilat nuk kanë të shënuar të dhëna, ose të dhënat nuk korrespondojnë me përmbajtjen që ka medikamenti, dhe mos harroni, që kemi shumë ilaçe të kushtueshme për jetën e qytetarëve, të cilat kanë po aq rrezik sa ka edhe ushqimi, madje barnat e kanë efektin e rrezikshëm më të shpejtë, sesa produktet bujqësore dhe blegtorale, pasi hyjnë drejtpërdrejt në organizëm dhe në gjak.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Luli.

Pra, “mashtrimi për produktet ushqimore”, paragrafi i parë është me dy paragrafë.

Kujtim Luli – Neni 284/d është një dispozitë që bën një mbrojtje të posaçme të veprimtarisë në fushën e barnave. Po t’i shikojmë të gjitha elementet e anës subjektive të kësaj vepre, i gjejmë edhe tek ajo që sapo kaluam, te neni 188/2.

Çfarë ka plus neni 288/d? Është më e qartë si dispozitë. Te cilat? Tek ato elemente që lidhen me llojin, me kategorizimin, prejardhjen, origjinën, të cilat mund të parashikohen te materialet e falsifikuara. Ku bëhet falsifikimi? Bëhet në etiketë dhe në të gjitha elementet që përmbledh fjala “falsifikim”, që lidhen me prejardhjen, origjinën, kategorizimin, sasinë dhe cilësinë e produkteve. Nëse ke një bar të falsifikuar, i ke në të gjitha këto elemente. Fjala “e falsifikuar” e përmbledh tërësinë e këtyre elementeve që janë më të qarta këtu, por, kur shkohet te

protokolli i barnave pastaj, falsifikimin e gjen më të zërthyer kur do të shkosh te një masë dënimi konkrete.

Ulsi Manja – Mund të bëj një pyetje lidhur me nenin 288/d? Pse nuk e keni lidhur paragrafin e parë të këtij neni me rrezikshmërinë për shëndetin dhe jetën e njerëzve?

Kujtim Luli – E kemi lidhur “ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin”.

Ulsi Manja – Te paragrafi i parë, nuk kërkon ardhjen e asnjë pasoje.

Kujtim Luli – Duhet ta vendosim!

Ulsi Manja – “Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, falsifikimi”, duhet të mbahet e njëjta linjë.

Kujtim Luli – Duhet mbajtur i njëjti standard si te neni 288, edhe te neni 288/d, sepse përndryshe do të jemi para një kundërvajtjeje administrative...

Ulsi Manja – “... etiketimi i produkteve ushqimore apo barnave, duke e bërë produktin të rrezikshëm për jetën ose shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim”. Pra, paragrafin e parë nuk e kemi lidhur me pasojat që mund t’i vijnë jetës dhe shëndetit të njeriut. E kemi lënë thjesht kështu siç është. Ndërsa paragrafin e dytë e kemi lidhur me “ose kur ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut”.

Ju lutem, lexojeni edhe një herë nenin 288.

Elena Xhina – “Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, falsifikimi, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin dhe përpunimin e artikujve ushqimorë të pijeve në të cilat janë shënuar të dhëna, të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë së cilësisë së produktit, apo produktet pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, ose paraqitja e të dhënave të rreme në etiketimin e produkteve ushqimore, që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohen me burgim deri në 3 vjet”.

Ulsi Manja – Dakord jam.

(Diskutim pa mikrofon)

Elena Xhina – Atë po lexoj dhe shtova pasojën që kërkuat. E riformulova në moment.

Vasilika Hysi - Ju keni qenë një nga firmëtarët e nismës. Qëllimi për të kriminalizuar mashtrimin me produktet ushqimore, përfshirë pijet apo barnat, ka qenë për të penalizuar pavarësisht ardhjes së pasojës dhe, nëse vjen pasoja, kjo të jetë një vepër me rrethana rënduese, këtu duhet bërë një dallim. Nëse qëllimi juaj, si nismëtarë, është për të penalizuar dhe për të

inkriminuar çdo mashtrim me barnat dhe produktet, pavarësisht pasojës së ardhur, për të mos lënë pastaj një subjektivizëm nëse vdekja e një qytetari ka ardhur sepse ka marrë barna, apo sepse ka arsye të tjera natyrale dhe e hidhni në duart e mjekësisë ligjore për të përcaktuar fajësinë për shkakun e vdekjes, pra, nëse ne duam t'i japim fund çdo lloj abuzimi që bëhet me fenomenin e sigurisë ushqimore, që nga fermeri, tregtari, shpërndarësi, nga importuesi, nga ai që e porosit jashtë që të ketë më pak tregues dhe ta marrë me çmim më të ulët dhe për ta shitur në tregun shqiptar, kjo është një gjë tjetër, por nëse ne do ta lidhim me pasojën, mendoj se nuk kemi bërë asgjë.

Ulsi Manja – Po, pra me pasojat i lidhim edhe ne.

Kam një pyetje: sot, sipas ligjit për ushqimin (të më korrigjojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë), lejohet prodhimi i djathit duke pasur edhe disa nënprodukte deri në një përqindje të caktuar. Flas për niseshtenë, vajin e palmës e të tjera, por kjo është e përcaktuar në legjislacion sa duhet të jetë raporti mes këtyre përbërësve dhe qumështit në rastin konkret, nga i cili prodhohet djathi. Si e zgjidh neni 288/d rastin kur kemi mashtrim, kur këto raporte nuk janë në përputhje me atë që parashikon ligji për ushqimin?

Kleves Janku - Është rregulluar me vendim të Këshillit të Ministrave për etiketimin. Në rast se pastaj bëhet e dëmshme për shëndetin, kalojmë në vepër penale. Pra, këtu është limiti që kemi vendosur.

Ulsi Manja – Zonja Hysi ka një propozim konkret ku thotë: paragrafi i parë nuk do të duhet të lidhet me pasojat te jeta dhe shëndeti, por duhet të rrijë siç është në variantin e propozuesve.

Kështu që zoti Luli mund të na japë një shpjegim rreth këtij neni 288/d, paragrafi i parë.

Kujtim Luli – Ky nen i ka të specifikuar të gjitha elementet deri te pjesa e paraqitjes së rrethanave të rreme edhe në etiketime. Unë mendoj se standardi i kësaj dispozite duhet të jetë si ai i nenit 288, duke shtuar edhe pjesën “që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve”. Pra, nëse ato përbëjnë një shkelje ligjore kur nuk rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve, duhet të shkojë në kundërvajtje administrative. Nëse fillon rrezikohet shëndeti dhe jeta e njerëzve, ato duhet të jenë në nivel penalizimi.

I njëjti standard siç është te neni 288, të shkojë edhe për pasojat në dëm të rëndë të shëndetit, në dëm të jetës ose të disa personave. Edhe kjo duhet të shkojë në standardin e formulimit të dispozitës për pasojat që mund të sjellë kjo lloj veprimtarie në shkelje të ligjit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ne po diskutojmë dy çështje dhe këtë do të doja ta ndaja: e para, pa hyrë nëse duhet të jenë në një linjë apo jo. Në parim propozuesit, kur kanë sjellë këtë propozim, nuk e kanë lidhur me pasojën, por e kanë lidhur me “përdorimin, importimin, falsifikimin, mashtrimin e të tjerë” dhe do të quhet vepër penale. I qëndrojnë këtij qëndrimi, apo jo?

E dyta, zoti Luli, ju thoni se duhet të jenë në një linjë me nenin 288. Po, është e vërtetë, por sapo e miratuar këtë nen. Paragrafi i parë i këtij neni nuk ka lidhje...

Ju thoni se rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi. Kush do ta përcaktojë e rrezikon apo jo jetën një ilaç i falsifikuar, i cili është marrë dhe efektet i ka dhënë më vonë? Kush e përcakton që vdekja nuk ka ardhur nga përdorimi i ilaçeve, por është një vdekje e akumuluar e të tjerë...

Ulsi Manja – Po çfarë keni me ilaçet këtu? Pijet dhe barnat i hoqëm ne.

Vasilika Hysi – Kryetar, lidhet edhe me nenin 284, që është aktualisht në Kodin Penal.

Pra, ajo që do të doja ta ndaja (që të jem e qetë edhe kur ta votoj), do të ndëshkojmë vetëm kur këto vepra rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, apo në çdo rast? Kaq do të doja të dija.

Ulsi Manja – Të jem më konkret, t’i bashkohem edhe unë shqetësimit të zonjës Hysi: ka falsifikuar etiketën e djathit. Etiketa nuk i korrespondon përmbajtjes reale që ka produkti. Është 80% vaj palme dhe 20% produkt qumështi, gjë që është tërësisht e ndaluar dhe e dëmshme. Ai e ka vendosur në etiketë “Djathë i bardhë brenda standardeve”, ndërkohë që thotë 80% qumësht, përbërësit 20% vaj palme u konstatua ky falsifikim i etiketës. Pra, do ta lidhim me ardhjen e pasojës, që nga përdorimi i kësaj sasive konsumi djathi është shkaktuar dëmtimi i shëndetit të njeriut apo mjafton vetëm falsifikimi i etiketës së produktit.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Më pas le të flasë edhe Kujtimi, por kur ne themi që rrezikojnë jetën dhe shëndetin, kjo nuk është pasojë, nuk po themi që e ka rrezikuar, por është duke e rrezikuar me veprimin që ka kryer. Kjo gjë nuk duhet keqkuptuar.

Ulsi Manja – Pra, flitet për rrezikimin jetës dhe të shëndetit.

Elena Xhina – Kjo nuk është pasojë, sepse pasoja është te paragrafi i dytë.

Ulsi Manja – Nuk ka ardhur pasoja.

Elena Xhina – Jo, pasoja nuk ka ardhur, por shkalla e rrezikshmërisë është më e lartë. Për shembull, sa mund të jetë shkalla e rrezikshmërisë të një çokollatë që ka një javë që i kaluar afati?

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për përfaqësuesin e Ministrisë së Bujqësisë. Ju si ekspertë të fushës a jeni të gjendje të përcaktoni që një produkt i falsifikuar, jo këto me një skadencë të vogël, jam duke folur për ato që janë totalisht të falsifikuar, a mund ta përcaktoni dot shkallën e rrezikshmërisë së jetës apo të shëndetit të personit nëpërmjet analizave që ju bëni? Kjo është për ju për AKU-në apo kushdo qoftë tjetër.

Kleves Janku – Kjo varet rast pas rasti.

Ulsi Manja – Po, zonja Mara.

Aurora Mara – Unë mendoj se dalim komplet nga sensi i çështjes që kemi kërkuar. Propozimi që është bërë nga grupi i deputetëve ka qenë në sensin që fenomeni të zhduket dhe jo të presim pasojat. Në momentin që ne presim pasojat fenomeni nuk zhduket, zoti kryetar. Nëse ne do të presim pasojat që sjell ky fenomen, i cili është kaq i dëmshëm për shoqërinë tonë, tragjik për momentin, atëherë ne nuk marrim masat e duhura. Pra, ne rrimë dhe presim pasojat dhe pastaj i dërgojmë njerëzit në burg kur vijnë pasojat.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Luli, një konsideratë të fundit, sepse nuk jemi duke folur për ardhjen e pasojave, por për rrezikun e këtyre pasojave.

Kujtim Luli – Për ta përmbyllur, dua t’ju them, duke u nisur edhe nga ato që po dëgjoj nga diskutimet, vullneti i ligjberësit është për të ngritur nivelin e kësaj përgjegjësie pa pasojë, pa rrezikuar jetën dhe shëndetin e personave. Në thelb, kjo lloj veprimtarie përbën një falsitet të paraqitjes së të gjitha këtyre produkteve me mashtrim para një klienti, i cili është një qytetar. Ne e dënojmë falsifikimin edhe kur firmos një copë letër që mund të jetë e një pjesëtari të familjes, sepse edhe kjo përbën falsitet. Nëse do t’i shkojmë me këtë logjikë, që niveli i përgjegjësisë të shkojë drejtpërdrejtë që nga momenti që ai nxjerr një prodhim, i cili pasqyron të dhëna të rreme dhe false në përmbajtjen e tij, të ngrihet në nivel vepre penale pa pasojë, pra ngelet në rrethana cilësuese kur shkakton pasoja.

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Gjoni.

Më pas do të kalojmë në votim.

Ralf Gjoni – Zoti kryetar, të kthehemi pak në bazë, të dalim pak nga ana juridike dhe të kalojmë në anën njerëzore. Jemi duke folur për ashpërsimin e legjislacionit në një vend si Shqipëria, ku niveli i inflacionit, niveli i abuzimit, në gjuhën popullore niveli i të futurës është skandaloz, pasi shumica e fermerëve, e tregtarëve janë të papërgjegjshëm dhe çdo gjë e kanë me të futur ndaj klientit.

Unë mendoj se çdo premisë dhe çdo analizë jona juridike duhet të nisët nga baza e ashpërsisë maksimale ndaj kësaj lloji papërgjegjshmërie që shohim në treg. Para se të vijë këtu, po gatujmë për vajzën time, po jua sjell si rast, mora një pako me porçini të ngrirë që e kisha blerë në një dyqan, e cila kishte vetëm një etiketë në shqip dukej që nuk ishte nga Italia, pra ishte produkt shqiptar, kutërbonte një erë të tmerrshme dhe e hodha.

Niveli i papërgjegjshmërisë në Shqipëri është jashtëzakonisht i lartë, prandaj unë mendoj se kjo gjë duhet ashpërsuar dhe për këtë arsye nuk e mbështes këtë propozim.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Hedhim në votim nenin 288/d “Mashtrimi me produktet ushqimore”, sepse është krejt korrekte futja e fjalës “që rrezikojnë jetën”, nuk kërkohet ardhja e pasojës, por mjafton rrezikimi i jetës.

Kush dakord me nenin 288/d, sipas variantit të propozuar nga relatorja? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 288/d.

Kalojmë te neni 288/e.

Zonja Xhina.

Elena Xhina – Në nenin 288/e kemi bërë një riformulim të teknikës legislative, si dhe kemi propozuar që paragrafi i fundit të hiqet. Po jua lexoj, sepse ndryshon që në titull: “Prishja e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore”.

“Prishja me dashje e shenjave të sigurisë të vendosura nga organet shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për qëllime mbikëqyrjeje, kontrolli ose pezullimit të veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike mbi mjetet e transportit ose mbi mallra, me qëllim lëvizjen e mallrave ushqimore ose rifillimin e aktivitetit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj”.

Sa i përket paragrafit të dytë kemi menduar që ai nuk duhet të jetë, pasi mendojmë se nuk përbën ndonjë rrethanë cilësuese fakti që mallrat janë të kontaminuara ose të paidentifikuara, sepse për sa kohë këto janë me shenja sigurie, patjetër që kanë problematika, prandaj mendojmë që mjafton vetëm paragrafi i parë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Kam një pyetje. Pse është zbutur masa e dënimit këtu, sepse ne kemi propozuar që dënohet me burgim deri në 3 vjet?

Elena Xhina – Pyetje e drejtë. Ne e kemi diskutuar dhe grupin e punës dhe kemi vendosur që masa e dënimit të zbutet, pasi personat që i kanë këto mallra dhe që mund të jenë me problematika konsumojnë edhe vepra të tjera penale që ne sapo i miratim. Automatikisht, kjo është prishja e masave të sigurisë nuk është konsumimi i veprës penale...

Ulsi Manja – Erdhi AKU-ja dhe e mbylli, në rastin konkret, i vuri shiritat që ky mall që është këtu të rrijë aty, sepse është mall që rrezikon jetën dhe shëndetin e njerëzve. Ata i thyejnë shenjat e sigurisë, hapin dyqanin dhe fillojnë shitjen e produktit.

Elena Xhina – Në këtë rast ka dy vepra penale, është kjo, por është edhe fakti që po shet një produkt që është i falsifikuar dhe rrezikon jetën dhe shëndetin. Ne nuk duhet ta lidhim këtë me konsumimin e veprës bazë kryesore.

Qëllimi i dispozitës me aq sa unë po kuptoj nga ana juaj është që të mos thyhen shenjat e sigurisë.

Ulsi Manja – Në fakt, le të konkurrojnë dy veprat dhe të zgjidhet...

(Diskutime pa mikrofon)

Elena Xhina – Konkurrimi nuk zgjidhet vetëm nga masa e dënimit, zoti kryetar.

Ulsi Manja – Zgjidhet më e lehta përherë ajo që favorizon masë dënimi. Përfaqësuesi i Euraliusit, çfarë mendimi keni.

Tedi Dobi – Në fakt, ulja e masës së dënimit ka qenë një nga propozimet e misionit të Euralius-it dhe logjika më pas ka qenë fakti, që neni 222 i Kodit Penal parashikon: “Shkatërrimi i qëllimshëm i vulave apo i shenjave të tjera të vendosura në objekte të ndryshme nga prokuroria dhe nga organet gjyqësore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 6 muaj”.

Pra, ishte sugjerimi ynë që i njëjti model të zbatohet edhe në këtë rast si për nenin **322**, sepse është e njëjta logjikë. Ashtu siç bëhet shkatërrimi i vulave dhe i tërë shenjave që janë vendosur nga prokuroria për skenën e një krimi që është diçka goxha e rëndë po i njëjti parim proporcionaliteti të zbatohet në këtë rast, sepse do të ekzistonte frika që për një dënim më të madh do të ishte joproporcionale.

Ulsi Manja – Nëse është ndjekur kjo logjikë për ta barazuar si dispozitë me prishjen e shenjave të organeve të prokurorisë ose të organeve gjyqësore, qëllimi i ligjvënësit në rastin konkret është krejtësisht tjetër. Pra, ne e konsiderojmë me rrezikshmëri më të madhe shoqërore prishjen e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore, për ne ky është qëllim tjetër.

Unë propozoj që për masën e dënimit t'i rikthehemi variantit të propozuesve, që të dënohet me burgim deri në 3 vjet.

Kush është dakord me nenin 288/e me propozimin për rritjen e masës së dënimit, të dënohet me burgim deri në 3 vjet? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 22 që ndryshon nenin 293.

Zonja Xhina e ka fjalën.

Elena Xhina – Sa i përket nenit 22, që ndryshon nenin 293, i vetmi ndryshim i dispozitës është që nga ana e deputetëve nismëtarë është hequr lidhëza “dhe” dhe është vendosur “ose”, duke qenë se më parë vepra kërkonte që të kryheshin veprimet në mënyrë akumulative veprimet, ndërsa këtu janë alternative.

Ulsi Manja – Pra, te neni 293 “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit” ka qenë “vënia e pengesave dhe ndalimi” dhe për pasur elementet e kësaj vepre kërkoheshin në mënyrë akumulative të dyja, propozuesit thonë: “Vënia e pengesave ose ndalimi” dhe pjesa tjetër e dispozitës nuk ndryshon dhe mbetet po ajo që është në Kodin Penal.

Po, zoti Dobi.

Tedi Dobi - Ka qenë edhe një koment që ka ardhur nga Euraliusi me shkrim. Për ne heqja e lidhëzave “dhe” dhe “ose” mund të ketë disa problematika, pasi ky formulim i propozuar mund të jetë i gjerë dhe mund të rrezikojë shkeljen e parimit të proporcionalitetit, duke qenë se në shumicën e vendeve, si për shembull në rastin e Gjermanisë, vepra të ngjashme lidhen me ndërprerjen e rrezikshme të formave të transportit, atij hekurudhor për shembull.

Gjithashtu, mund të ketë problematika në lidhje me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila me një vendim të saj nr.112/2000 ka arritur në përfundimin se vendimi administrativ për mos të ndaluar një demonstratë nga protestuesi mjedisor, që rezultoi me mbylljen e një autostrade në Brener për gati 30 orë, ishte një shprehje e të drejtave themelore.

Në sugjerimin tonë kjo do të ketë nevojë për një element kualifikues që të jetë në përputhje me parimet e proporcionalitetit.

Ulsi Manja – Jam shumë dakord, por kjo dispozitë zgjidh një situatë, kur nuk bëhet fjalë për demonstrata të ligjshme ose protesta të ligjshme. Këtu bëhet fjalë për rastet kur në mënyrë të dhunshme pengohet qarkullimi i transportit automobilistik, hekurudhor, uJOR ose ajror.

Se, normalisht, kur bëhet fjalë për protesta të ligjshme, patjetër që kjo dispozitë nuk e penalizon vënien pengesave.

Specialisti – Edhe ne do të ishim dakord, nëse vendoset në këtë dispozitë ky element kualifikues i ushtrimit të dhunës ose dëmtimit, por në formatin se si ka ardhur është shumë e thjeshtë dhe nuk ka një element kualifikues në të.

Ky është i vetmi shqetësim që ne kemi.

Ulsi Manja - Faleminderit!

A jemi dakord me nenin 293, duke zëvendësuar lidhësen “dhe” me “ose”?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 293.

Kemi lënë një nen të hapur, nenin 207/c, i bie neni 10 i projektligjit. 207/c ka qenë: “Shkelja e rregullave të vetëmbajtjes së kafshës së shoqërimit”.

Elena Xhina – Propozohet të mbahet riformulimi i sjellë nga Prokuroria e Përgjithshme dhe të titullohet “Braktisja e kafshëve të shoqërimit”, duke u lidhur direkt me pasojën:

Kur nga braktisja e kafshës së shoqërimit ose mosvendosja e maskës mbrojtëse të kafshës së shoqërimit në ambiente publike ose në mjedise të hapura për publikun kanë ardhur pasoja në dëm të shëndetit të një personi dënohet me gjobë ose burgim deri në 6 muaj.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e rëndë e një personi, dënohet me burgim nga 1-5 vjet.

Kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një personi, dënohet me burgim nga 3-10 vjet.

Ulsi Manja – Pra, është riformuluar neni 207/c. Titulli i dispozitës është bërë “Braktisja e kafshëve të shoqërimit”, me tre paragrafë sipas riformulimit që lexoi relatorja.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 207/c.

Kemi edhe disa propozime të tjera.

Elena Xhina – Propozimet i kemi fillimisht te neni 52/a, i sjellë nga Këshilli i Ministrave dhe nga Ministria e Brendshme.

Propozimi i parë lidhet me pjesën e përgjithshme, neni 52/a, ku kërkohet të bëhet një riformulim në paragrafin e dytë me përmbajtjen “Viktima e veprave penale të trafikimit të personit përfiton përjashtimin nga dënimi për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit në masën që ka qenë e detyruar t’i kryej ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme”. Këtu dua

të shtoj se i vetmi ndryshim është që më parë ka qenë opsion, ka qenë “mund të përfitojë”, ndërsa tani bëhet detyrues “përfiton”.

Kujtim Luli – Mund apo s’mund? Ajo fjala “mund” është e domosdoshme. Po ta shikojmë në legjislacion gjykata mund ta bëjë, thuhet dhe do t’ia nënshtrojë vlerësimit të faktit dhe ligjit, nëse i takon apo jo. Pra, fjala “mund” është krejt normale në një dispozitë të tillë dhe po t’ia heqësh këtë mundësi, pse po e çon në gjykatë atëherë?

Ulsi Manja – Unë jam dakord me logjikën e zotit Luli, që në rast se do të jetë automatik përjashtimi nga dënimi nuk ke pse shkon në gjykatë, prandaj fjala “mund” te neni 52 i lë hapësirë gjykatës.

Zonja Xhina, unë mendoj se duhet ta tërheqim ndryshimin e propozuar.

Elena Xhina – Është e drejtë. Jemi dakord ta heqim nga propozimet.

Ulsi Manja – Pra, neni 52/a ngelet kështu siç është në Kodin Penal.

Kalojmë te nenet e tjera.

Elena Xhina – Dua të them se në këtë nen nga Ministria e Brendshme është bërë një bashkim me nenin 128/b. Tashmë kërkohet të shfuqizohet neni 128/b dhe të bashkohet me nenin 110/a, sepse neni 110/a “Trafikimi i personave të rritur”, ndërsa neni 128/b flet për trafikimin e të miturve. Tashmë këto dy nene janë bërë një dispozitë e vetme, duke u quajtur “Trafikimi i personave”.

Ne kemi bërë vetëm një rregullim të teknikës legjislative.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Luli!

Kujtim Luli – Nuk jam dakord me këtë ndryshim për të bashkuar dispozita. Në Kodin Penal ka një mbrojtje të posaçme që u bëhet të miturve në trafikim. Legjislacioni është ndryshuar në vitin 2013. Unë nuk di të ketë probleme, as edhe nga rekomandimet të Komisionit European ose të Këshillit të Europës.

Kur të ndryshohet Kodi Penal në tërësi, të shikohen nëse është e nevojshme të bëhet ky bashkim.

Ulsi Manja – Mendoj që ky bashkim i dy dispozitave të mos merret në konsideratë dhe në të vazhdojmë me dy dispozitat që kemi, nenin 110/a dhe nenin 128/b.

Nëse, kur të hartohet Kodi i ri Penal, grupi i punës, pas një analize dhe studimi dhe pas rekomandimeve që mund të ketë në kuadrin e përafrimit, le ta marrin në konsideratë bashkimin e këtyre dy dispozitave.

Kalojmë te neni 121.

Elena Xhina – Lidhur me nenin 121 kemi edhe një amendim të propozuar nga deputetet Eglantina Gjermani dhe Evis Kushi, i cili ngre të njëjtat shqetësime që u ngritën te neni 121, që të silltet për ndryshim nga KM-ja.

Ne kemi bërë një riformulim duke shkruar të dy propozimet. Propozimi që ka sjellë ministria, (e keni në tabelën e mesit) është “Ndërhyrja pa të drejtë në jetën private”. Në tabelën e parë është dispozita siç është sot. Në tabelën e dytë është propozimi i qeverisë, ndërsa në tabelën e tretë është një shprehje të dispozitave, si të amendimeve të sjella nga deputetët, ashtu edhe nga qeveria.

Varianti përfundimtar në kolonën e tretë është: “vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose figurave. Dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim të të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit, pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Shpërndarja apo publikimi me çdo mjet ose formë të komunikimit publik i të dhënave të marra në mënyrën e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni ose kërcënimi për kryerjen e veprimeve të mësipërme dënohet me burgim deri në 2 vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet ndaj personave të mitur, dënohet me burgim nga 1-3 vjet.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik apo nga personi që disponon këto të dhëna, për shkak të detyrës shtetërore apo shërbimit publik, dënohet me burgim nga 1 deri 3 vjet.

Këtu dua të shtoj se paragrafi i fundit është analizuar edhe lidhur me veprën penale të përhapjes së sekreteve vetjake, kur bëhet nga personi, që ka për detyrë të mësojë këto, por mendojmë se nuk ka lidhje me këtë dispozitë, pasi këtu kemi të bëjmë vetëm me rastet e imazheve dhe të bisedave...

Ulsi Manja – Në nenin 121 kërkohet t’u jepet mbrojtje juridiko-penale disa aspekteve të ndërhyrjes në jetën private të personit, kryesisht bëhet fjalë për shantazhin nëpërmjet telefonit, videove, për shantazhin që u bëhet personave lidhur me aspektet e jetës private.

Po, zonja Mara.

Aurora Mara - Zoti kryetar, unë mendoj se duhet të ndahet vendosja e aparaturave nga transmetimi, pra vendosja është një gjë dhe transmetimi i çdo gjëje është diçka tjetër. Për mendimin

tim vendosja mund të dënohet me gjobë, por tek transmetimi i çdo gjëje private nuk ka vend gjoba. Ju mund ta diskutoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është tjetër të vendosësh që ta dëgjosh diçka vetë në intimitet dhe tjetër ta transmetosh intimitetin e tjetrit në publik. Pra, vendosja dhe transmetimi janë dy akte të ndryshme.

Ulsi Manja - Diferencimin te masa e dënimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aurora Mara - Ju lutem, se dua të jem shumë e qartë!

Vendosja mund të dënohet me gjobë, por transmetimi është komplet akt tjetër, është dhunim i të drejtave. Te vendosja mund ta konceptoj gjobën, thjesht vendos një aparat dhe ndoshta e dëgjoj vetëm, por tek transmetimi i jetës private të tjetrit nuk mund ta lejoj gjobën, se është komplet akt tjetër, është dhunim i të drejtave private.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Falënderoj zonjën Mara, sepse ka shumë të drejtë në shqetësimin që ngre!

Nuk e di se çfarë ka pasur parasysh qeveria te fjala “transmetim” te paragrafi i parë, kur në paragrafin e dytë thuhet: “shpërndarja”. “Shpërndarja” është ajo për të cilën ngre shqetësimin zonja Mara. Unë propozoj ta heqim fare fjalën “transmetim” nga paragrafi i parë.

Ulsi Manja – Ta heqim fjalën “transmetim” nga paragrafi i parë dhe ta lëmë “shpërndarja”. Nëse heqim “transmetimin” dalim aty ku e thekson zonja Mara.

Ulsi Manja - Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Si titulli dhe paragrafi i parë i nenit 121 është *copy -paste* te paragrafi i parë i propozuar dhe titulli i propozuar. Meqenëse mendohet që të ndryshohet dhe unë jam dakord me arsyetimin dhe logjikën e deputetes që fjala “transmetim” nuk ka lidhje me vendosjen e aparaturave por është më tepër “shpërndarje”.

Ulsi Manja- Atëher, ta lidhim me paragrafin e dytë.

Kujtim Luli - Në paragrafin e dytë të përfshijmë edhe propozimin e të dyja deputeteve, e kanë bërë më të zgjeruar “shpërndarjen”. Unë kam bërë një riformulim: “Shpërndarja, ofrimi për publikim ose publikimi me çdo mjet ose formë të komunikimit publik apo mënyrë tjetër”, sepse “shpërndarja” mund të bëhet në rrjetet sociale, pa i përmendur “rrjetet sociale”, por edhe “me

çdo mënyrë tjetër i të dhënave të marra sipas paragrafit të parë të këtij neni dënohet me burgim deri në 3 vjet”, siç është propozuar nga të dyja deputetet.

Ulsi Manja - Pra, e ngre në nivelin e një krimi. Dakord

Kujtim Luli - Në vijim përsëri të dyja deputetet kanë bërë propozime për të shtuar disa paragrafë. Nuk e di nëse i keni marrë parasysh, tek neni 221, germa “b”. Për mua nuk shkojnë atje, por duhet të jenë pjesë e nenit 221. Mund të vendosen këtu në vazhdim si paragrafë.

Ulsi Manja – Dy koleget tona të nderuara kanë propozuar që të shtohet një nen i ri 121/b, pavarësisht se relatorja i ka përmbledhur në një. Që të jemi korrektë, titulli i dispozitës thotë: “Publikimi dhe shpërndarja e imazheve ose e filmimeve me përmbajtje erotike apo seksuale”. E kanë bërë të detajuar si dispozitë.

Nëse ju zoti Luli dhe relatorja bini dakord që përmbajtja e propozimit të të dyja kolegeve gje zgjidhje të riformulimi që ju i bëtë nenit 121, mendoj të mbajmë këtë formulim që ka propozuar relatorja.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Përfundimisht, propozoj të hiqet fjala “transmetim” nga paragrafi i parë. Paragrafi i dytë të riformulohet siç e lexoi zoti Luli dhe të vijojë dispozita siç është lënë.

Ulsi Manja - Ju lutem!

Siç është te kolona e tretë.

Elena Xhina - Po, siç është te kolona e tretë, por paragrafi i dytë të jetë ashtu siç e lexoi zoti Luli.

Ulsi Manja – Çfarë është marrë në konsideratë nga propozimi i kolegeve?

Elena Xhina – Është marrë çdo gjë, përveç faktit që kërkonin që disa subjekte të cilësohen, që janë ish - bashkëshorti e të tjera, por mendoj se gjen zgjidhje të dispozita. Megjithatë, mund ta diskutojmë nëse është e nevojshme.

Ulsi Manja – Zoti Luli, keni diçka për të shtuar?

Kujtim Luli - Ato parashikime mund të specifikohen këtu, sepse natyra e këtyre ndërhyrjeve në jetën private është veçori e atyre marrëdhënieve që duhen të penalizohen subjektet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Në një paragraf koleget tona propozojnë: “Po kjo vepër kur kryhet nga bashkëshorti, bashkëjetuesi, ish- bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi ose personi, i cili është apo ka

qenë në një marrëdhënie afektive ose lidhje shpirtërore me të dëmtuarin dënohet me burgim nga 1-4 vjet”. Shpeshherë në jetën e përditshme qenia në këto raporte çon mbrapa në konsumimin e veprës penale. Do ta marrim këtë paragraf? Cila është arsyeja që nuk është marrë në konsideratë?

Elena Xhina - Në nenin 50, pjesa e përgjithshme është një rrethanë rënduese kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare të bashkëjetesës, të miqësisë. Nuk ka arsye ta vendosim këtu më vete.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 121, me riformulimin e bërë nga relatorja? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Elena Xhina – Në nenin 197/a, që e prezantuam në mbledhjen e radhës, kërkohet të bëhet një ndryshim në veprën penale: “paracaktimi i rezultateve në garat sportive”, ku paragrafi i parë...
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk u prek neni 128.

Neni 197/a, vepra penale “Paracaktimi i rezultateve në garat sportive”, është kundërvajtje penale dhe propozohet të kriminalizohet, të bëhet krim. Ndryshon vetëm masa e dënimit.

Ulsi Manja - Neni 197 “Paracaktimi i rezultateve në garat sportive”.

Elena Xhina – Kemi një ashpërsim të masave të dënimit.

Bashkim Fino - Problemi është, a ka pasur dënime për këtë gjë? Ne bëjmë ndryshim në Kodin Penal, nga 3 muaj në 2 vjet, e shtojmë 1 deri në 3 vjet. Jam dakord, nuk kam asnjë merak se shtohet, por nëse do të më japë prokuroria apo gjykata statistikën që gjatë gjithë kohës që ka qenë në fuqi Kodi Penal, është zero, jam shumë i bindur se do të jetë zero dënimi për paracaktimin e rezultateve në garat sportive. Pyetja është: pse e bëjmë këtë ndryshim nga 1 në 3 vjet, kur ishte nga 3 muaj në 2 vjet, kur ne nuk kemi dënuar asnjëri? Ne e forcojmë, kur një dispozitë forcohet, nga eksperiencia ka një tendencë në rritje, nëse ka tendencë në rritje bëjmë mirë që e forcojmë, por në rastin konkret jam shumë i bindur që është zero, si nga prokuroria si nga gjykata, nuk ka pasur asnjë dënim për paracaktimin e rezultateve sportive. Meqenëse është zero dhe ne e rrisim dënimin, cili është motivacioni? Unë të paktën nuk kam dëgjuar në Shqipëri, për aq sa jam këtu dhe njoh mirë sportin për ndonjë sportist, klub, po flas për Shqipërinë se ky është Kodi Penal i Shqipërisë, nuk po flas për Kodin Penal të Francës, të Platinisë apo të UEFA-s, që të dënohet. Meqenëse nuk kam dëgjuar njeri të dënohet, unë nuk e kuptoj, se po i forcojmë ligjet dhe ato mbeten në letër.

Zoti kryetar, e kuptove, se ti nuk merr vesh nga sporti, por pa e aplikuar fare në praktikë, kërkojmë t'i ndryshojmë masën e dënimit, ta çojmë nga tre muaj në dy vjet, me idenë se ndoshta gjen zbatim në praktikë duke rënduar masën e dënimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbaruam, mbaruam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ideja është të fusim qëllimin e fitimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – E di çfarë tregon kjo, kryetar? Kjo tregon se do të ndodhë ndonjë paracaktim rezultatesh, dhe meqenëse do të ndodhë, ne themi: pse ta dënojmë shtatë vjet se kemi pasur Kodin Penal? I fusim një të dënuar një vit, se këtu thotë një deri në tre vjet. Kështu edhe ai pasurohet, sepse me lekët që do të marrë do të pasurohet, kështu që s'ka rëndësi që bën një vit burg, ndërkohë që këtu ka qenë shtatë vjet. Këtë kuptoj unë me ndryshimin që kërkoni të bëni. Unë jam i mendimit se Kodi Penal, siç ka qenë, është shumë i saktë, të paktën me këto masa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe të shikojmë se çfarë do të ndodhë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe unë mendoj që të ngelemi te varianti që ka Kodi Penal ekzistues. Nëse ky nen do të ketë nevojë të ndryshohet, le të merret në konsideratë nga hartuesit e Kodit të ri Penal, për të cilin po punojmë.

Zonja Xhina, besoj se biem dakord!

Elena Xhina – Po, po, këtë do të deklaroja, duke parë analizën që u bë.

Ulsi Manja – Kalojmë te neni tjetër.

Elena Xhina – Neni tjetër është neni 199/a. Kërkohej të ndryshohet. Në këtë dispozitë sillen elementë të rinj. Nuk besoj se është e nevojshme ta lexoj, sepse kolegët e kanë përpara, por unë dua të shtoj këtu, që ndryshimet e fundit të kësaj dispozite janë bërë në vitin 2015. Është bërë një ashpërsim i masave të dënimit, dhe nuk e shoh me vend që ne të vazhdojmë të fusim akoma elementë rëndues, duke ashpërsuar masat, kështu që unë propozoj që të mos merret në konsideratë as kjo dispozitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Në një vend ku menaxhimi i territorit, lejet e ndërtimit, pronësia e qytetarëve shqiptarë ndodhet në një kaos të vërtetë, është e tmerrshme që ne të rrisim masën e ndëshkimit për ata qytetarë të varfër, të cilët mund të ndërtojnë një copë mur pa leje. Unë jam plotësisht dakord me relatoren.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, kolegë! Zoti Fino...

Ralf Gjoni – Zoti Fino, e kam fjalën për shumë fshatarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për një copë mur kanë hyrë në burg, në fshat, në Baldushk, në Vishnje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Atëherë, propozohet ky ndryshim. Ne mendojmë se neni 199/a duhet të mbetet në variantin që ka Kodi Penal ekzistues. Mendojmë se është ezauruar shqetësimi që kemi me Kodin Penal ekzistues, që është ndryshuar në vitin 2015.

Ka edhe një propozim të fundit, të ardhur në grupin e punës, që i referohet pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

Zonja Xhina.

Elena Xhina – Ka ardhur një propozim tjetër, që synon të ndërhyjë në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht te neni 30. Kërkohej që pas pikës 10 të këtij neni, ku bëhet fjalë për dënime plotësuese, të shtohet pika 11, me këtë përmbajtje: “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Ky është një propozim i kolegut Ervin Bushati. Kaq.

Ulsi Manja – Pra, kolegu Ervin Bushati....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, ta lexoj deri në fund. Kolegu Ervin Bushati...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem! Zoti Braho...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal! Epo, bëje ti propozimin pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëje, formuloje aty!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk i thërresin një nga një.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do që të vijë? Ma bëj mua pyetjen, se të jap unë përgjigje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'ka nevojë ta vazhdojmë nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund ta thuash deri në fund propozimin e kolegut Bushati?

Elena Xhina – Zoti Bushati kërkon që në nenin 30, pas pikës 10 të shtohet një pikë më vete: “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, gjë e cila, si pasojë pasqyrohet dhe në nenin 43 të Kodit Penal. Propozohet që pas nenit 43/a të shtohet neni 43/b, me përmbajtje: “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë jepet nga gjykata për një kohë nga 5 - 10 vjet, ndaj personit...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Elena Xhina – Në këto kushte, zoti kryetar, për më tepër, do t'ju lutesha që këtë nismë ta sqaronit juve, meqenëse keni qenë prezent në diskutim.

Ulsi Manja – Po, po. më fal, të lutem! Le ta sqarojmë tamam nismën.

Neni 30 i Kodit Penal parashikon dënimet plotësuese. Janë dhjetë dënime plotësuese. Propozohet të shtohet një dënim, me 11, që ka të bëjë me ndalimin e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Pika 8 është nxjerrja jashtë territorit, dhe janë rastet e depërtimit nga Shqipëria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të të huajve. Tani propozohet një ndryshim tjetër: “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, i shqiptarëve, i shqiptarëve të cilët gjykata i ndëshkon për vepra penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik në Shqipëri. Nëse sot kemi një shqetësim në Shqipëri, të ngritur me të madhe nga opozita, për shitblerjen e votës, zgjedhjet e lira dhe demokratike, atyre qytetarëve shqiptarë që fusin duart te zgjedhjet e lira e demokratike, kur gjykata të shqiptojë

dënimin për njëren nga këto vepra, pse të mos u japë edhe dënim plotësues? E ka gjykata në dorë, jo ne.

Pra, le t'i japim një instrument në dorë gjykatës, që në rastet kur të kemi persona të dënuar për krime elektorale, gjykata të mund të japë edhe një dënim plotësues, i cili lidhet me ndalimin e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një kohë që e shqipton gjykata në vendimin e saj.

Kjo është e gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Lita e ka kërkuar fjalën.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Këtë propozim të zotit Bushati, unë e shikoj krejt të papranueshëm. Nuk është vendi këtu, që termat elektorale të Kryeministrit t'i bëjmë ligje. Ndryshimet ligjore në Kodin Penal janë vazhduar, ndaj s'ka asnjë lloj nevojë të bëhet kjo. Lëvizja e lirë e njerëzve është e garantuar me Kushtetutë. Me sa di unë, është dakordësuar nga dy palët ligji për ndryshimet në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Nëse gjykata të dënon pse ke futur duart në zgjedhje, në momentin që ti mbaron dënimin nuk ka asnjë lloj arsyeje dhe asnjë lloj logjike juridike të të ndalohej lëvizja e lirë e njerëzve. Kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë. Këtu po bëhet si në vitin 1945. Vini sërish klonin më mirë! Vërinë klonin Shqipërisë dhe jeni në rregull!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse i prek zgjedhjet e lira, dënohem, por në momentin që dal nga burgu, unë mund të shkoj ku të dua. Nuk mund ta çosh edhe në burg, edhe t'i thuash që s'ka të drejtë të dalë jashtë shtetit. Më mirë vërinë klonin Shqipërisë! Gjysmën e prokurorëve e ët gjykatësve i kemi po të njëjtit që kanë qenë në kohën kur ishte kloni dhe kufiri. E keni të ngritur strukturën për t'i penguar njerëzit që të dalin jashtë shtetit. Burrelin e keni të hapur akoma. Reçin e Shkodrës e keni bërë për ne politikanët, por ndoshta mund të propozojmë që politikanët t'i çojmë në Burrel, ndërsa në Reç të çojmë të burgosurit e tjerë.

Kështu, nuk ka asnjë lloj arsyeje që të bëhet kjo shtesë në Kodin Penal.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Gjoni!

Ralf Gjoni – Zoti kryetar, jam shumë dakord që të vijmë propozime të mirëmenduar e të mirëstudiuara për Kodin Penal, por ne nuk mund të lejojmë që Komisioni për Çështjet Ligjore, i

Kuvendit të Shqipërisë, të kthehet në një arenë cirku dhe teatri për agjendën politike të Partisë Socialiste. Ju lutem, ruani seriozitetin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lini të mbaroj!

Ruani seriozitetin e këtij komisioni! Po flasim për Kodin Penal. Kodi Penal nuk mund të vihet në funksion të një axhende të ngushtë politike, për zgjedhjet e javës së ardhshme.

Ju lutem të gjithë kolegëve, që në emër të profesionalizmit, si deputetë të Kuvendit, ta refuzojmë këtë propozim. Nuk mund të miratohet, sepse është i papranueshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Fino, një këndeje e një andej!

Bashkim Fino – Kryetar, s' më pëlqeu paragrafi i fundit i kolegut, që e kam edhe në krahun tim këtu. E para, ne jemi Komision i Ligjeve dhe po diskutojmë në lidhje me Kodin Penal. Deri tani kemi marrë në konsideratë shumë kërkesa, nga shumë deputetë apo grupe interesi. Nuk thamë gjë para tre minutave, që dy koleget tona kishin sjellë amendamente në lidhje me filmimet, incizimet, transmetimet e të tjera e të tjera, por e përmirësuam dhe thamë: ta bëjmë. Apo jo? Kjo do të thotë se këtu nuk është as teatër e as cirk. Çdo deputet ka të drejtë të bëjë propozime. Mbase do të ishte e udhës që, ashtu si dy koleget tona, edhe ai të ishte këtu, që të bënte një interpretim, një relativ të ndryshimeve që kërkon, dhe është më se në rregull dhe e logjikshme që ky komision t'i diskutojë.

Në qoftë se ju bashkoni momentin politik apo atë çfarë thotë Kryeministri nëpër mitingje, me ndryshimet që ne i bëjmë kodit, kjo është një rastësi, sepse kodi ka kohë që është këtu dhe kemi disa muaj që punojmë. Kjo nuk do të ketë fuqi prapavepruese, sepse, kur të kalojë në parlament, do të hyjë në fuqi dhe pas këtij momenti jam shumë i bindur se do të ketë kaluar data 30 qershor, e cila është edhe data e zgjedhjeve lokale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ka rëndësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dua të çmontoj atë përafrim që bëri zoti Gjoni mes deklaratave të Kryeministrit dhe Kodit Penal. Pra, kjo do të hyjë në fuqi kur ta diskutojmë ne në korrik, sa të dalë në Fletoren Zyrtare dhe sa të dekretohet nga Presidenti do të bëhet efektive nga muaji gusht, ndërkohë që

kryetarët e bashkive do të kenë dy muaj që kanë filluar nga puna. Por edhe ata që do të pengojnë zgjedhjet, nuk do t'i prekin këto ndryshime që po bëjmë.

Prandaj, i dashur, mos bëj retorikë politike, sepse nuk ka të bëjë me këtë. Është e drejta e çdo deputeti të bëjë propozime.

Ulsi Manja – Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Zoti Fino, jam dakord që kjo duhej të sillej në kohën e duhur. Këtu nuk ka asnjë material shpjegues për motivacionin e këtij propozimi. Ky nuk është i njëjti propozim dhe nuk ka të njëjtën natyrë me atë të dy kolegeve të nderuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, në gjykimin tim, kjo është e papranueshme.

Ulsi Manja – Po, zonja Mara.

Aurora Mara – Zoti kryetar, unë jam dakord me propozimin. E para, duhet të sqarojmë që është dënim plotësues dhe jepet në rastet kur dhënia e dënimeve kryesore çmohet e papërshtatshme dhe kur ligji parashikon burgim deri në 3 vjet ose dënime të tjera. Pra ndalimi i daljes jashtë territorit të Shqipërisë është minimumi që mund të japësh për kryerjen e këtyre veprave penale, të cilat dhunojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Faleminderit!

Ulsi Maja – Po, zoti Lita.

Korab Lita – Zoti kryetar, këtu nuk bëhet fjalë për procedurën, por për përfundimin e saj. Si mundeni që me vendim gjykate t'i ndaloni dikujt të dalë jashtë shteti? Ju lutem, gjeni vetëm një rast në botën perëndimore që një gjyqtar ka të drejtë t'i ndalojë një qytetari të dalë jashtë shteti.

Ulsi Manja – Ta jap unë përgjigjen.

Korab Lita – Ju lutem, kjo është të mbyllësh kufijtë e Shqipërisë, si në vitin 1945. Pas asaj që po ndodh në Bashkimin Europian, pra pas refuzimit të hapjes së negociatave, ju bëni dhe elementin plotësues, ku i ndaloni njerëzit edhe nga brenda. Pra, ju po vendosni kufijtë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lita!

Përpara se ta hedh në votim, dua të them se si aplikohet në praktikë. Unë bashkohem edhe me shpjegimin që bëri zonja Mara. Në rast se dikush do të shkojë në gjyq për pengim të subjekteve zgjedhore, për falsifikim të materialit zgjedhor apo për dëmtim me dashje të materialit zgjedhor,

gjykata në shqiptimin e dënimit mund të japë burgim me 1 deri në 5 vjet, por mund të zgjedhë edhe dënimin plotësues për këtë person. Pra, nuk jep dënim me burgim, por zgjedh dënim me ndalimin e daljes nga Shqipëria për një periudhë 5, 6 apo 10-vjeçare.

Korab Lita – Ju keni 10 variante aty, përse doni të shtoni edhe një dhe t’i bëni 11? Kjo është shumë politike.

Ulsi Manja – Zoti Braho ka një mendim.

Spartak Braho – Problemi qëndron...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë do të thotë kur një person kryen veprën penale të cenimit të zgjedhjeve? Këtë nuk e kuptoj unë.

Kurse te fjalia e dytë, ku thuhet: “Sistemi demokratik i zgjedhjeve”, kjo ka ndodhur përpara viteve 90-të dhe është agjitacion dhe propagandë.

Ju e shpjeguat shumë mirë se çfarë nënkuptohet me cenim të zgjedhjeve, pra prishje, ndërhyrje, falsifikime, sherre e të tjera, prandaj duhen sqaruar edhe këtu.

Ulsi Manja – Ju keni të drejtë, ne duhet t’i referoheni saktësisht kreut X të Kodit Penal, ku thuhet: “Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”. Këtu ku thuhet: “Kryhet një vepër penale që cenon...”, fjala “cenon” duhet të zëvendësohet me fjalët “që prekin zgjedhjet e lira”, ashtu siç e ka Kodi Penal në kreun X. Pra, “Veprat penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve...” dhe thuhet: “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë jepet nga gjykata, për periudhën siç është propozuar, pra nga 5 deri në 10 vjet ndaj personave që kryejnë vepra penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, ashtu siç e ka titulli i kreut X të Kodit Penal. Këtu janë të listuara...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të atij kreu, patjetër. Atëherë, propozohet që pas pikës 10 të nenit 30 të shtohet pika 11 me këtë përmbajtje: “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Kush është dakord? Kundër? 2 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Propozohet që pas nenit 43/a të shtohet neni 43/b me këtë përmbajtje: “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, pra reflektimi i atij ndryshimi që bëhet te neni 30, me formulimin që lexova më sipër. Kush është pro? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në paragrafin e dytë të nenit 44...

Elena Xhina – Atëherë, në paragrafin e nenit 44, togfjalëshi “dhe 8” të zëvendësohet me togfjalëshin “8 dhe 11”

Ulsi Manja – Pra, reflektimi të bëhet edhe te neni 44, i cili ka të bëjë me mënyrën e vuajtjes së dënimeve plotësuese. Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”, nismë e një grupi deputetësh. Kush është pro? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Përpara se ta mbyllim mbledhjen e komisionit, kemi edhe një votim tjetër. Në këtë komision kemi kaluar dy nisma për ndryshime në Kodin Penal. E para ka qenë nismë e një grupi qytetarësh, të cilën e kemi votuar në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe kishte të bënte me disa ndryshime në lidhje me mbrojtjen e kafshëve, ndërsa paketa që sapo votuam është nismë e një grupi deputetësh.

Në seancën plenare teksti integral i projektligjit, meqenëse kemi të bëjmë me ndryshime në Kodin Penal, do të jetë në një variant të integruar të dyja nismat me numërtimet përkatëse. Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet teksti integral i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Raporti i komisionit së bashku me numërtimin e ri, që do të marrin nenet në tekstin integral, të bëhen gati për seancën plenare.

Po e mbyll me një falënderim për kolegen tonë Elena Xhina, si relatore e projektligjit, për të gjithë deputetët e komisionit, që kanë qenë të përfshirë në grupin e punës dhe që kanë dhënë kontributin e tyre në pasurimin e këtij drafti. Gjithashtu, falënderoj zotin Luli, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, zotin Dobi i misionit EURALIUS, Avokatin e Popullit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Mjedisit, që ishin kontribuues në përmirësimin e këtij drafti.

Po ashtu një falënderim të veçantë e kam edhe për kolegët e komisioneve të tjera, që ishin për dhënie mendimi dhe në mënyrë të veçantë për zonjën Kushi, zonjën Gjermani dhe kolegun Bushati.

Mbledhja tjetër do të zhvillohet nesër në orën 10:00.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA